

## Komuna e Vushtrrisë 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

### Hyrje

Vushtrria qeveriset nga Partia Demokratike e Kosovës. Kryetari aktual i komunës Bajram Mulaku po e përmbyll mandatin e tij të tretë. Në zgjedhjet e fundit për kryetar të komunës (nëntor 2013), Mulaku ka fituar në balotazh ndaj Muharrem Shabanit nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ky i fundit në raundin e parë ka siguruar 6,801 vota (apo 22%), ndërsa Mulaku ka pasur 11,838 vota (apo 39%). Në balotazh Mulaku ka siguruar 10,329 vota (55%).<sup>1</sup>

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.<sup>2</sup> Afro 99% e qytetarëve të Vushtrrisë konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>3</sup> Sipas studimit të UNDP, 74% e qytetarëve në Vushtrrisë janë shprehur të kënaqur me punën e Kryetarit të Komunës, përderisa me pak se gjysma e qytetarëve, përkatësisht 44% kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>4</sup>

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Vushtrrisë. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujit të pijes, deponit ilegale, nxjerrja e thëngjillit në Zhilivodë, ndotja e lumenjve, mungesa e kanalizimit, mungesa e vendkalimeve për autobus, mungesa e parkingjeve si dhe mungesa e çerdheve.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2szzr1OU> (Qasur me 18.06.2017)

<sup>2</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU> (Qasur me 19.06.2017)

<sup>3</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>4</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 dhe 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>5</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Vushtrrisë 2013. Burim <http://bit.ly/2rFJ0BM>

## Problemet aktuale të Komunës së Vushtrrisë

### Uzarpimi i pronave publike komunale

Në shumë vendbanime të Vushtrrisë është e shprehur dukuria e uzurpimit të pronave publike, pjesa më e madhe e tyre ka ndodhur në periudha të mëhershme, por që autoritetet komunale nuk kanë ndërmarr ndonjë masë ose veprim në kthimin e këtyre pronave. Kjo dukuri ka prekur edhe zonat urbane veçmas ato që janë afër pompës së derivateve “Kosova Petrol” si dhe përgjatë zonës në afërsi të restorant “Holiday”. Edhe në afërsi të urës se gurit të këtij qyteti hasen uzurpime.<sup>6</sup>

### Rreziku nga shembja e shtëpisë së kulturës

Shtëpia e kulturës “Hasan Prishtina” në Vushtrri rrezikon të shembet shkaku i mos riparimit dhe restaurimit të saj. Salla e madhe e këtij objekti është jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve. Dëmtimet janë të vazhdueshme edhe shkaku i depërtimit të ujit gjatë të reshurave. Autoritetet komunale fillimisht si opsion e kanë shqyrtuar rrënimin e këtij objekti, por nga presioni publik opsion i rrënimit është tërhequr, por akoma nuk ka ndodhur riparimi dhe konservimi.

### Mungesa e parkingjeve

Qytetarët e Vushtrrisë si problem të vazhdueshëm e kanë mungesën e parkingjeve publike pasi komuna nuk u ka vënë në dispozicion parkingje të mjaftueshme. Mungesa e parkingjeve i shtyn vozitësit që veturat t’i parkojnë në trotuare dhe në vendet të tjera jo adekuate. Ky problem daton qysh para zgjedhjeve të fundit lokale (2013)

### Mungesa e rrjetit të kanalizimit

Një problem tjetër i vazhdueshëm me të cilën ballafaqohen banorët e komunës së Vushtrrisë është edhe mungesa e rrjetit të kanalizimit. Ky problem po ndikon në masë të madhe në ndotjen e mjedisit e sidomos në shpërndarjen e ujerave të zeza të cilat po i ndotin burimet e ujit të pijes në ato vende ku nuk ka ujësjellës. Nga sasia e madhe e ujërave të zeza po ndoten edhe lumenjtë Sitnica dhe Tërstena pasi këto ujëra po derdhen në to. Rreth 50 fshatra të Komunës së Vushtrrisë nuk kanë fare rrjet të kanalizimit. Në mesin e tyre janë fshatrat Akrahticë, Pantinë, Oshlan, Strofc, Zhilivodë, etj.

---

<sup>6</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

### **Ndotja e lumenjve**

Komuna e Vushtrrisë është ndër komunat e pakta në Kosovë që e përshkrijnë tre lumenj. Por, lumi Sitnica, Terstena dhe lumi Studimja janë të ndotura. Në lumin Terstena hidhen mbeturinat e fshatrave Karaçë, Novosellë e Begut, Dumnicë. Një lum tjetër që përshkon tërë Kosovën, lumi Sitnica, është gjerësisht i ndotur nga banorët e fshatit Pestovë. Ndërsa, në fshatin Samadrexhë në Lagjen e Bonjakeve, përveç që hidhen mbeturinat në lumin Studimja, aty derdhen edhe ujërat e zeza. Banorët e këtij vendi disa herë e kanë pastruar në mënyrë vullnetare këtë lum. Në lum janë hedhur edhe materiale ndërtimore.

### **Mungesa e rrjetit të ujësjellësit**

Për dallim nga zgjedhjet e kaluara kur njeri ndër problemet kryesore të kësaj komune ka qenë mungesa e ujit të pijes, ky problem është zbutur dhe kjo gjendje paraqitet tani më e mirë. Por problem vazhdon të mbetet mungesa e rrjetit të ujësjellësit në shumë vendbanime, veçmas në fshatra. Fshatrat që nuk kanë rrjet të ujësjellësit janë: Balincë, Banjskë, Beçiq, Beçuk, Bivolak Ceceli, Dobrelluk, Dalak, Dumnicë e Poshtme, Studime e Poshtme, Stanoc i Poshtëm, Svaraçak i Poshtëm, Druar Duboc, dhe Galicë.<sup>7</sup>

## **Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje**

### **Mbrojtja dhe promovimi i kalasë së vjetër në qytet**

Komuna e Vushtrrisë është kritikuar nga shoqëria civile, mediat dhe ekspertet për shkak të një vendimi të saj për t'i dhënë një të afërmi të kryetarit kalanë e qytetit që ai të shndërrojë në një restorant. Ky vendim dhe vendime tjera si ky duhet shmangur në të ardhmen. Trashëgimia kulturore duhet trajtuar e konsideruar si pasuri e përbashkët dhe jo të tjetërsohet për përfitime materiale të subjekteve private .

### **Mos tjetërsimi i tokës bujqësore**

Komuna e Vushtrrisë konsiderohet të ketë klasën më të mirë të tokës bujqësore në Kosovë. Patatja prodhohet kryesisht në tokat bujqësore në Vushtrri. Në vitet e fundit janë rritur rastet kur toka e paraparë si bujqësore është kthyer me vendime të urbanizimit në tokë ndërtimore. Këto transformime nuk duhet lejuar. Komuna

---


<sup>7</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të zhvillimeve lokale.

duhet të tregohet e vëmendshme duke pamundësuar dhe dekurajuar rastet e tilla.

## Trendet buxhetore në Komunën e Vushtrrisë (2017)

Komuna e Vushtrrisë në vitin 2017 ka planifikuar 15.9 milion euro buxhet.<sup>8</sup> Kurse përveç planifikimit të rregullt buxhetor Komuna e Vushtrrisë ka bartur rreth 520 mijë euro nga të hyat vetanake të vitit të kaluar, ndërsa në vitin 2013 ishin barur 440 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Vushtrrisë ka pasur një rritje prej 3.3 milionë euro të buxhetit. Krahasuar buxhetin e vitit 2017 me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013), rritja e buxhetit është bërë në kategorinë e pagave, por ka pasur rritje të buxhetit në investime kapitale dhe në mallra dhe shërbime. Në krahasim me vitin 2013, në vitin 2017 buxheti për paga është rritur për 2.3 milionë euro (apo 31%), ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale buxheti është ngritur rreth 641 mijë euro (apo 17%) më shumë krahasuar me vitin 2013. Ndërsa krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Vushtrrisë është rritur për 27 persona në vitin 2016. Përveç numrit të rregullt të punëtorëve, në komunë janë punësuar 22 persona me kontratë për shërbime të veçanta gjatë vitit 2016.


**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Vushtrrisë 2017



<sup>8</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>


Nga buxheti total komunal i Vushtrrisë 60 % e buxhetit ndahet vetëm për paga, për investim kapitale 28 %, përqindje më të vogla ndahen për tri kategorit tjera ekonomike.

**Figura nr.2:** Trendët buxhetore në Komunën e Vushtrrisë 2013-2016



Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2016 ka pasur të hyra komunale në vlerë prej 1.4 milionë euro, shumë kjo përafërsisht e njëjtë me realizimet e të hyrave të shënuara edhe në dy vitet tjera paraprake.

**Figura nr.3:** Të hyrat vetanake në Komunën e Vushtrrisë 2013-2016



**Burimi:** Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendët buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna e Vushtrrisë duhet t'i lirojë të gjitha hapësirat e uzurpuara në qytet nga subjekte të ndryshme afariste.
- Komuna duhet të nisë restaurimin e shtëpisë së vjetër të kulturës me qëllim të evitimit të rrezikut nga shembja.
- Komuna duhet ta mbrojë dhe promovojë kalanë dhe urën e vjetër të qytetit. Rastet si ai i gjysmës së vitit 2017 kur kalaja i është dhënë në shfrytëzim një biznesi nuk duhet përsëritur.
- Komuna duhet të rrisë investimet për të zgjeruar rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Komuna duhet të gjejë mënyra për të ndaluar dukurin e hedhjes së mbeturinave në lumin e qytetit.

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*